



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

Date 22.01.2018

SHPALLJE

Për dhënien me qira

1. Të pasurisë Nr.337, ZK 1900, “pemtore” me sipërfaqe 11,700 m², të ndodhur në fshatin Gurishtë, Njësia Administrative Përg.
2. Të pasurisë Nr.338, ZK 1900, “arë” me sipërfaqe 9,500 m², të ndodhur në fshatin Gurishtë, Njësia Administrative Përg.

Toka bujqësore, jepet vetëm në rastet e shfrytëzimit të saj për veprimtari bujqësore.

Çdo subjekt, person fizik dhe/ose juridik, vendas apo i huaj i cili kërkon të marrë me qira tokat arë të sipërpërmendura duhet të paraqesë një kërkesë me shkrim drejtuar Kryetarit të Bashkisë Maliq, ku të përfshihen:

- Të dhënat e kërkesës/ Vërtetim për shlyerje të detyrimeve nga organet vendore;
- Afati i qirasë;
- Veprimtaria bujqësore që do të zhvillohet mbi tokën e marrë me qira, duke përcaktuar kulturat bujqësore ose speciet e bimëve me të cilat lidhet kjo veprimtari;
- Aspektet kryesore të teknologjisë që do të aplikohet në kultivimin e bimëve, si dhe përpunimin e produkteve;
- Investimet kryesore mbi infrastrukturën (kullim, ujitje, sistemimin etj.), të shprehura në tregues, fizikë dhe monetarë, si dhe investimet e lidhura me mbjelljen e kultivimin e bimëve dhe me përpunimin e produkteve etj.;
- Burimet e financimit që garantojnë investimin, të shprehura në vlerë monetare, si dhe bilanc financiar i të ardhurave;
- Ndikimin e investimit në rritjen e numrit të të punësuarve në komunën ose bashkinë përkatëse;
- Propozimin për çmimin e ofruar për marrjen e tokës bujqësore me qira (lekë/ha në vit)
- Vërtetimin e lëshuar nga DAMT-ja e Qarkut, ku të tregohet kategoria e resursit të tokës bujqësore, siç rezulton në dokumentacionin kadastral;

- Plan i hollësishëm i biznesi.

Dokumentacioni i mësipërm duhet të dorëzohet pranë Zyrës së Protokollit të **Bashkisë Maliq brenda 10 ditëve nga e nesëmja e shpalljes.**

Data e zhvillimit të konkursit 15.02.2018 ora 09.00

Vendi i zhvillimit të konkursit: Bashkia Maliq

Kriteret e vlerësimit dhe sistemi i pikëzimit:

1. Teknologjinë që do të aplikohet në kultivimin e bimëve, si dhe në përpunimin e produkteve -10 pikë;
2. Investimet kryesore mbi infrastrukturën (kullim, ujitje, sistemimin etj.), të shprehura në tregues, fizikë dhe monetarë, si dhe investimet e lidhura me mbjelljen e kultivimin e bimëve dhe me përpunimin e produkteve etj- 20 pikë;
3. Ndikimin e investimit në rritjen e numrit të të punësuarve në Bashkinë e Maliqit- 20 pikë;
4. Propozimin për çmimin e ofruar për marrjen e tokës bujqësore me qira (lekë/ha në vit) - 40 pikë (çmimi minimal i ofruar nuk mund të jetë më pak se 6000 lekë/ha në vit)

U shpall në datë 22.01.2018

Kryetar i KQTBP-së së Bashkisë Maliq

Vasillaq ÇINOKU

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim TOPÇIU

